

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lufta e padukshme e Kremlinit: nga kokat e derrave te ndërhyrjet në zgjedhje
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/14/lufta-e-padukshme-e-kremlinit-nga-kokat-e-derrave-te-n-derhyrjet-ne-zgjedhje/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:48:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:40:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	34e57b4bb1b09b3d23b2d17a3cafa7f48320393710ee81c890a9b7b1fbc5ae72
TEKSTI	a2d75634a3b6c42f521dfd7fd70fc0c7383e6adf68d7069a4dde74b64c629e96
PAMJA	4c0b21767ed7509582f6fd19002a32f23e8697257e5587368d5cfed22759a3e1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f37f700be273fa53c6559ffef21da182859538ee6de19bda05177c4854bff1b5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f37f700be273fa53c6559ffef21da182859538ee6de19bda05177c4854bff1b5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lufta e padukshme e Kremlinit: nga kokat e derrave të ndërhyrjet në zgjedhje

Kryesore

Publikuar: 14/09/2026

f X



Dokumente dhe biseda të brendshme të rrjedhura kanë zbuluar një rrjet operacionesh të dyshuara ruse të ndikimit në Evropë, të konceptuara për të nxitur përçarje sociale, tensione fetare dhe politike dhe për të ndikuar në opinionin publik e në procese zgjedhore.

Hetimi është publikuar nga OCCRP, në bashkëpunim me gazetarë të Delfi Estonia dhe media të tjera partnere. Dokumentet tregojnë rolin e *Social Design Agency* (SDA), një kompani ruse e sanksionuar nga SHBA, Britania e Madhe dhe Bashkimi Evropian për fushata ndikimi, si dhe lidhjet e saj me administratën presidenciale ruse.

Në dokumentet e brendshme, operacionet përshkruhen me termin “goditje njohëse” (*cognitive strikes*) kundër Perëndimit. Objektivi, sipas një prej materialeve, ishte thellimi i kontradiktave të brendshme në vendet perëndimore, nxitja e protestave dhe aktivizimi i pjesëve të elektoratit në vendet e NATO-s. Një element domethënës i strategjisë ishte shmangia e mesazheve haptazi proruse, në mënyrë që ndikimi të ishte më pak i dallueshëm.

Koka derrash përpara xhamive në Paris

Një nga operacionet më tronditëse lidhet me ngjarjen e shtatorit 2025, kur koka derrash të prera dhe të lyera me gjak u vendosën përpara nëntë xhamive dhe qendrave kulturore në Paris dhe rrethinat e tij. Mbi to ishte shkruar me bojë blu emri “Macron”.

Tre shtetas serbë u dënuan më pas në Serbi për përfshirjen në këtë operacion. Sipas vendimeve gjyqësore të cituara nga hetimi, ata ishin drejtuar nga “struktura të shërbimit të inteligjencës së Federatës Ruse”, me synimin për të nxitur trazira dhe intolerancë

Me të lexuarat

- Rama “djeg” Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e përcaktuara...
- Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t’ia dhënë...
- Besnik Leskaj i mori në punë të birin. Postet në...
- Administratë e...
- i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë...
- Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozit...

Një dokument tregon edhe organizimin e aksionit. Sipas tij, gjashtë operativë mbërritën në Paris më 7 shtator, kryen zbulimin e terrenit një ditë më vonë, vendosën kokat e derrave natën pasuese dhe më pas u larguan nga Franca. Në raport evidentohet si sukses edhe mbulimi i gjerë që ngjarja mori në mediat ndërkombëtare.

Operacionet nuk synonin vetëm komunitetin mysliman. Të njëjtët persona, sipas vendimeve gjyqësore, kishin hedhur bojë të gjelbër mbi Muzeun e Holokaustit dhe disa sinagoga në Paris, si dhe kishin vendosur skelete plastike pranë Portës së Brandenburgut në Berlin. Qëllimi i përcaktuar nga gjykata ishte nxitja e intolerancës mes hebrenjve dhe myslimanëve dhe destabilizimi i situatës në Francë dhe Gjermani.

Nga vandalizmi te manipulimi politik

Dokumentet zbulojnë edhe operacione të tjera. Në Gjermani, qindra automjeteve iu mbushën tubat e shkarkimit me shkumë dhe iu vendosën etiketa me mesazhin "*Be greener!*", në atë që duket se ishte një përpjekje për t'ia faturuar vandalizmin Partisë së Gjelbër.

Edhe më shqetësuese janë planet që, sipas hetimit, nuk u realizuan ose të paktën nuk janë raportuar publikisht. Një dokument parashikonte përdhosjen e një monumenti të Charles de Gaulle në Paris në mënyrë që përgjegjësia t'u atribuohet "nacionalistëve ukrainas". Autorët e aktit madje duhej të bindeshin se po vepronin në interes të Ukrainës. Një plan tjetër parashikonte hedhjen e 30 kukullave seksuale në lumin Senë me një mesazh kundër emigrantëve.

Armenia dhe zgjedhjet në shënjestër

Një pjesë e rëndësishme e dokumenteve lidhet me Armeninë. Sipas materialeve të rrjedhura, SDA planifikonte të përdorte median "Yerevan One", të drejtuar ndaj diasporës armene në Rusi, për të krijuar qëndrime negative ndaj qeverisë dhe kryeministrit Nikol Pashinyan, ndërsa promovonte forcat që mbështesnin lidhje sa më të ngushta me Moskën.

Dokumentet përshkruajnë gjithashtu fushata dezinformimi kundër Pashinyanit dhe presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskyy. Një histori e rreme pretendonte se Pashinyan kishte blerë një vilë luksoze në Marsejë, ndërsa një tjetër pretendonte se Zelenskyy kishte blerë për nënën e tij një apartament luksoz në Burj Khalifa të Dubait. Sipas raporteve të brendshme, historia e fundit arriti mbi 86 milionë shikime, megjithëse më pas u përgënjeshthua.

Planet për 2026: inteligjencë artificiale dhe mijëra "opinion leader"

Operacionet duket se nuk i përkasin vetëm së shkuarës. Një dokument me titull “Projects 2026” rendit tetë projekte, disa prej të cilave përshkruhen si tashmë të nisura.

Mes tyre janë një bazë njohurish e drejtuar nga inteligjenca artificiale dhe e orientuar drejt Gjermanisë, një databazë për monitorimin e afro 10 mijë llogarive të personave me ndikim në rrjetet sociale, një sistem për ndjekjen e 100 figurave kryesore të opozitës franceze dhe projekti “AI News”, i orientuar drejt Francës dhe i konceptuar për prodhimin e qindra videove në gjashtë rrjete sociale.

Një tjetër projekt, i quajtur “Mitteleuropa”, parashikon krijimin e lidhjeve më të ngushta politike dhe ekonomike mes Austrisë, Hungarisë dhe Sllovakisë, me synimin afatgjatë të krijimit të një poli të ri rajonal. Dokumenti flet gjithashtu për synimin për të dobësuar Grupin e Vishegradit dhe për ta zëvendësuar atë me një “Marrëveshje të Vjenës”.

Dokumentet nuk lejojnë që çdo operacion t’i atribuohet automatikisht Kremlinit: OCCRP thekson se shumë prej tyre nuk kanë autor të identifikueshëm, ndaj nuk është gjithmonë e mundur të përcaktohet nëse një plan konkret ka origjinën te SDA, administrata presidenciale ruse apo një strukturë tjetër.

Megjithatë, tabloja që del nga dokumentet është ajo e një strategjie që nuk synon thjesht përhapjen e propagandës proruse. Objektivi është më i sofistikuar: të shfrytëzohen ndarjet që ekzistojnë brenda shoqërive perëndimore, të krijohen incidente që duken sikur vijnë nga vetë këto shoqëri dhe më pas konflikti, zemërimi dhe mosbesimi të amplifikohen në media dhe rrjetet sociale.

Burimi: OCCRP

TAG: [Kremlini](#) [Lufta](#) [Occrp](#)

Të ngjashme

Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Pacolli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t’ia dhënë biznesmenit izraelit Ron Yeffet

Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administratë të djalit të kryebashkiakut të Shkodrës, si i pa...

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuar me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategorite

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.